



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raport

VJETOR I PUNËS SË
MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL

2011

2

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar mandatin e ri si rezultat i zgjedhjeve të lira dhe demokratike në muajin shkurt 2011. Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal është zgjedhur z. Slobodan Petrovic.

Pozitat e zëvendës ministrave janë plotësuar 30 ditë më vonë dhe me këtë akt është kompletuar Kabineti i Ministrisë me ekipin e zëvendësministrave, këshilltarëve dhe stafit mbështetës për nevojat e kabinetit.

Miratimi i Rregullores Qeveritare për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive nr. 02/2011 ka rritur spektrin e përgjegjësisë të MAPL-së të përcaktuar me legjislacionin përkatës edhe në fushën e zhvillimit regjional dhe të menaxhimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

Përpilimi i raportit të punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është dizajnuar në modelin që të evidentoj punën që është bërë për të realizuar planin e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjinë Afatmesme për Punën e

Ministrisë dhe Planit Vjetor të Punës. Raporti përmban të dhëna në përmbushjen e objektivave të zhvillimit institucional të bazuar në legjislacionin dhe dokumentat strategjike për vetëqeverisjes lokale.

Objektivat e përgjithshme për vitin 2011 janë listuar si vijon:

- *Zhvillimi i bashkëpunimit regjional e ndërkombëtar në fushën e vetëqeverisjes lokale*
- *Avancimi i vetëqeverisjes lokale dhe reformës së pushtetit lokal*
- *Bashkëpunimi ndërkufitar*
- *Integrimet Evropiane*
- *Rritja e kapaciteteve institucionale të komunave*
- *Promovimi i respektimit të të drejtave e të njeriut*

Për të realizuar këto objektiva Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pasur një buxhet në lartësi prej 8,309,859.00 Euro dhe 138 të punësuar në administratën e ministrisë.

Përmbajtja e raportit dhe Periudha e raportimit

Raporti vjetor i punës së MAPL-së përmban aktivitetet e radhitura sipas kronologjisë duke u bazuar në fushat dhe përgjegjësitë që MAPL ka sipas legjislacionit në fuqi. Raporti përfshinë periudhën e raportimit nga janari deri në dhjetor 2011, duke u koncentruar në aktivitetin politik të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, aktivitetet e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së Komunave, aktivitetet për reformën e pushtetit lokal, zhvillimin regjional dhe bashkëpunimin ndërkufitar, integrimet evropiane, matjen e performancës së cilësisë së shërbimeve komunale, aktivitetet për rritjen e kapaciteteve institucionale si dhe promovimin e të drejtave të njeriut në komuna.

Koordinimi i aktiviteteve

Koordinimi i aktiviteteve të ministrisë në raport me komunat është bërë përmes agjendës së vendosur në kalendarin vjetor dhe që ka përmbajtur por nuk është kufizuar në: vizitat e rregullta të ministrisë në komuna, takimet e ministrit me kryetarë të komunave, takimet me kryesuesit e asambleve komunale, dhe takimet me drejtor të departamenteve sipas fushave në varësi të agjendës së punës. Për realizimin e kësaj agjende Ministri ka vizituar të gjitha komunat në fillimin e vitit (që është edhe fillimi i mandatit të tij) derisa rundi i dytë i vizitave është realizuar nga ekipi i në gjysmën e dytë të vitit. Janë realizuar 13 takime me kryetarë të komunave, 4 me kryesues të Asambleve Komunale dhe rreth 30 takime me drejtorë të departamenteve përkatëse.

Kjo strukturë e komunikimit është vendosur për të rritur aftësinë koordinuese, të informimit reciprok dhe të rritjes së transparencës së punës së MAPL-së dhe Komunave.

4

NGA PERSPEKTIVA E MINISTRIT

Në vitin e parë të punës, Zëvendëskryeministri dhe Ministri Petrovic me qëllim që të avancojë realizimin e reformës së pushtetit lokal ka instaluar në punën e tij dhe të ministrisë pesë (5) parimet themelore të punës:

- Bashkëpunim total me vendet në regjion. Për këtë qëllim Ministri Petrovic ka realizuar vizita në Republikën e Malit të Zi, Shqipërisë, Serbisë dhe Kroacisë. Në fokus nga pikëpamja e kompetencës janë trajtuar çështjet për avancimin e sistemeve të vetëqeverisjes lokale dhe bashkëpunimit lokal ndërkombëtar, përmes iniciativave të binjakëzimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta ndërkufitare.
- Bashkëpunim total me mediat vendore dhe ndërkombëtare për të siguruar transparencë të plotë. Për këtë qëllim ministri ka bërë 142 deklarata, 13 intervista televizive, 20 intervista me media të shkruara etj. Komunikimi në media ka qenë në stacione televizive të rangut botëror si BBC, EURONEËS, Zëri i Amerikës, Evropa e Lirë, në media nacionale të regjionit (Serbi, Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci etj) dhe mediat kosovare. Ka marr pjesë në shumë debate publike përfshirë Qendrën Mediale në Çagllavicë.
- Bashkëpunim total me institucionet ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

Bashkimin European. Ka pasur aktivitet të plotë koordinues dhe veprues me institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, përfshirë ambasadorët e shteteve të akredituara në Kosovë, Zyrën Civile Ndërkombëtare, Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian etj. Po ashtu ministri ka realizuar 2 vizita të suksesshme në: Ëashington D.C, Neë York dhe Bruksel.

- Bashkëpunim total me institucionet kosovare. Një kujdes të veçantë i ka kushtuar koordinimit ndërministror, me agjencionet e pavarura dhe me Parlamentin e Kosovës. Në asnjë rast dhe pa asnjë vonesë është përgjigjur apo ka marr iniciativë kur ka qenë e nevojshme në këtë nivel të komunikimit.
- Bashkëpunim total me qytetarë. Në agjendën e vet ka pasur takime të rregullta me grupe të qytetarëve nga komunitet e ndryshme, për të kuptuar brengat e tyre dhe ndihmuar eliminimin e tyre. Ka takuar grupe të qytetarëve pothuajse nga të gjitha komunat e Kosovës.
- Bashkëpunim me institucionet e shkencës dhe artit. Ministri ka prezantuar në disa universitete me renome botërore si Universiteti Kolumbia në Neë York, Universiteti Arcaida në Philadlefia, Universiteti John Hopkins në Ëashington D.C, takimet me studentë në disa universitete private në Kosovë, etj.

REFORMA E VETËQEVERISJES LOKALE

1.1 Kuadri ligjor për reformën e vetëqeverisjes lokale

MAPL ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet për përmbushjen e obligimeve të saj sipas agjendës legjislative për vitin 2011, me qëllim të kompletimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal dhe Ligjin për qytetin e Prishtinës.

Në tre ligjet, ministria brenda afatit të përcaktuar kohor me Agjendën legjislative të Qeverisë ka kryer obligimet e saj dhe ka proceduar konform Rregullores së punës së Qeverisë.

Me qëllim të kompletimit të bazës ligjore me legjislacionin sekondar për komunitat, gjatë kësaj periudhe MAPL ka nxjerrë dhe ndryshuar disa aktet si vijon:

- 1** Ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për themelimin e njërive për të drejtat e njeriut në komuna;
- 2** Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve si dhe
- 3** Nxjerrja e udhëzimit të ri administrativ për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në komuna.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2011, MAPL rregullisht është përfaqësuar në grupet punuese ndërministrorë, duke u përkujdesur që legjislacioni sektorial të jetë në harmoni të plotë me parimet e vetëqeverisjes lokale që i garanton kushtetuta dhe legjislacioni bazik për vetëqeverisje lokale. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka dhënë kontributin e saj në gjithsej 15 ligje sektoriale që bien në kompetencë të ministrive sektoriale të sponsorizojnë këtë legjislacion dhe që kanë ndikim në organizmin dhe funksionet e komunave.

6

1.2 Kuadri institucional për reformën e vetëqeverisjes lokale

Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal ka realizuar aktivitetet për decentralizimin, bazuar në Planin e veprimit për implementimin e decentralizimit si një ndër dokumentet strategjike më të rëndësishëm të miratuar në fushën e Decentralizimit. Në këtë dokument strategjik ishin përcaktuar objektivat që do të realizohen përsa i përket reformës së decentralizimit në sektorët e shërbimeve publike, arsimin, shëndetësinë, shërbimet sociale si dhe funksionalizimin e Komunave të reja të krijuara.

1.2.1 Grupi ndërmintoror për Decentralizim

Grupi Punues Ndërmintoror për Decentralizim, i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe drejtohet nga ministri Petrovic, misioni i së cilit është të avancojë reformën e decentralizimit nga perspektiva strategjike sipas planit të veprimit për decentralizim, gjatë vitit 2011 ka mbajtur 3 takime. Gjatë këtij viti aktiviteti i GND-së është mbështetur në arritjen e progresit në komunat e reja duke u fokusuar në fushën e shëndetësisë, buxheteve komunale, avancimin e sistemit të policisë. Njëkohësisht edhe katër nëngrupet tjera: Nëngrupi Punues për Reformë të Legjislacionit dhe Bartje të Kompetencave ka mbajtur; Nëngrupi Punues për Themelimin e Komunave të Reja; Nëngrupi Punues për Koordinim me Donatorë dhe Ngritje të Kapaciteteve; dhe Nëngrupi Punues për Fushatë informuese, kanë mbajtur gjithsej 7 takime dhe kanë realizuar të gjitha objektivat strategjike me përjashtim të themelimit të Komunës së Mitrovicës së Veriut.

1.2.2 Ekipi përgatitor i Komunës së Mitrovicës

Gjatë vitit 2011 është riorganizuar dhe ristrukturuar Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut, i cili ka vazhduar aktivitetet e tij për të adresuar problemet e qytetarëve, lidhur me procesin e decentralizimit. Në vazhdimësi EPK është

mbështetur nga MAPL duke kontribuar në informimin e publikut të gjerë në lidhje me procesin e decentralizimit dhe përgatitjen e terrenit për të krijuar komunën e re të Mitrovicës. Në këtë drejtim janë hartuar draft-rregulloret komunale që do të mund t'i hyjnë në punë strukturave të reja që do të krijohen pas themelimit të komunës së re dhe realizimin e projekteve për investime kapitale të cilat direkt kanë ndikuar në jetën e qytetarëve. Me ndihmën e ekipit përgatitor komunal janë realizuar 3 projekte kapitale në Mitrovicën e Veriut.

1.2.3 Qendra për Shërbime të Qytetarëve Mitrovicë Veriore

MAPL, në bashkëpunim me ministritë e linjës si Ministrinë e Tregtisë dhe industrisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Administratës Publike, në maj të vitit 2011 ka bërë hapjen e Qendrës për Shërbime të Qytetarëve në lagjen e Boshnjakëve në Veri të Mitrovicës. Në kuadër të kësaj Qendre gjendet Zyra për Regjistrim të Bizneseve, Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve, Zyra e Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të qytetarëve të Veriut të Kosovës. Shërbimet që ofron kjo zyrë koncentrohen në mbështetjen për aplikimet dhe nxjerrjen e Pasaportave dhe Letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës, nxjerrjen e certifikatave të të

gjitha llojeve të parapara sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të Republikës së Kosovës si dhe regjistrimet e automjeteve që mbështeten nga Zyra për Regjistrimin e automjeteve. Në këto zyra kanë marrë shërbime një numër i konsiderueshëm i qytetarëve nga veriu i Kosovës. Numri i tyre është rritur në mënyrë progresive dhe mesatarisht rreth 700 qytetarë në muaj përdorin këto shërbime të ofruara nga Qeveria e Kosovës, përmes koordinimit që bëhet nga MAPL.

1.2.4 Funksionalizimi i Komunave të reja

Është bërë progres në funksionalizimin e Komunave të reja. Me këtë rast, aktivitetet e MAPL-së gjatë vitit 2011 është fokusuar në transferimin e kompetencave, ngritjen e kapaciteteve të tyre institucionale dhe mbështetjen financiare të projekteve kapitale që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Në të gjitha komunat e reja ka filluar ndërtimi i godinave administrative të komunave. Po ashtu objektet për spitalet dhe qendrat kryesore të mjekësisë familjare janë duke u ndërtuar në çdo komunë. Projektet tjera në fushën e infrastrukturës rrugore, ambientit, arsimit etj janë përfunduar dhe me këtë po rumbullakojmë infrastrukturën fizike të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

Gjithashtu përveç projektet kapitale të

komunave të reja, është përkushtuar kujdes në mbështetjen e komunave të reja edhe në fushat si vijon:

- *Ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të komunave të reja përmes trajnimeve,*
- *Instruksiioneve dhe dokumenteve përkatëse gjatë procesit buxhetor;*
- *Planifikimin dhe ekzekutimin fleksibil të buxhetit për komunat e reja, të përcaktuar me ligjin vjetor të buxhetit;*
- *Azhurnimin e regjistrave kodues si dhe faturave të tatimit në pronë;*
- *Azhurnimin e regjistrave dhe procedurave në mes komunave amë me komunat e reja për alokimin e të hyrave nga dënimet e trafikut;*
- *Respektimi i kërkesës së kryetarëve të komunave të reja për përcaktimin e numrit të stafit administrativ komunal me buxhetin e planifikuar për vitin 2010, 2011 dhe 2012;*
- *Implementimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit të arritura në mes komunave amë me komunat e reja, si: në administratë komunale, programin e arsimit parauniversitar, shëndetësi etj.*

1.3 Reforma e vetëqeverisjes lokale, përtej obligimeve nga Pako e Ahtisaarit

Gjatë vitit 2011, MAPL ka punuar në drejtim të vendosjes së kriterëve për Komunat e reja që mund të krijohen, përtej obligimeve që dalin nga Pako e Ahtisaarit. Gjatë këtij viti MAPL ka hartuar dokumentin “Parimet dhe Kriteret për themelimin e Komunave të reja” ku janë përcaktuar parakushtet ligjore për formimin e një komune të re, procedurat ligjore të aplikueshme për formimin e komunës së re në kuptimin e përmbushjes së kriterit gjeografik, numrin e popullsisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike. Me këtë rast, janë zhvilluar një seri e konsultimeve me komunitetet në lidhje me mundësitë për krijimin e komunave të reja. Gjatë vitit 2011 në lidhje me këtë çështje janë përgatitur edhe disa përgjigje parlamentare. Sipas definimit ligjor këto dokumente do të aplikohen pas shpalljes së rezultateve finale të regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare dhe këto aktivitete janë përgatitur për të siguruar infrastrukturën e nevojshme të politikave dhe kriterëve për organizmin e ri territorial të kufijve administrativ të komunave.



1.4 PROMOVIMI I VETËQEVERISJES LOKALE DHE SHKËMBIMI I PËRVOJAVE ME SHTETET TJERA

1.4.1 Konferenca E Dytë Vjetore Për Vetëqeverisje Lokale

Me datë 5 dhe 6 shtator të vitit 2011 u mbajt konferenca e dytë vjetore ndërkombëtare për vetëqeverisje Lokale. Konferenca dy-ditore kishte për qëllim të sjellë së bashku përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes dhe të ministrive nga Kosova dhe rajoni, institucionet qeveritare, shoqëria civile, donatorët dhe agjencitë ndërkombëtare të përfshira në avancimin e vetëqeverisjes lokale të diskutojnë së bashku për sfidat e vetëqeverisjes lokale me qëllim të integritimeve Evropiane. Në

këtë konferencë morën pjesë më shumë se dyqind të ftuar. Përfaqësues të Komunave, Ministrive, shoqërisë civile, sektorit privat përfaqësues të qeverive të shteteve të rajonit dhe më gjerë, në mesin e tyre përfaqësuesit e shteteve si Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia, Turqia, u mbledhën bashkë dhe trajtuan tema në lidhje me reformën e pushtetit lokal dhe decentralizimin, reforma në legjislationin e vetëqeverisjes lokale dhe bashkëpunimin ndërkomunal dhe zhvillimin regjional.

2

VETËQEVERISJA
LOKALE

10

**2.1 Kuadri ligjor
për mbikëqyrjen e
ligjshmërisë së
komunave**

MAPL, bazuar në legjislacionin në fuqi është përgjegjëse të mbikëqyrë ligjshmërinë e akteve të komunave për të gjitha përgjegjësitë tjera të cilat ekskluzivisht nuk i janë caktuar ndonjë ministrie tjetër sektoriale për mbikëqyrje. Me këtë rast bën monitorimin e rregullt të punës së organeve komunale dhe monitorimin e performancës së shërbimeve komunale. Gjithashtu, me qëllim të precizimit të përgjegjësiave për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve komunale, është hartuar draft-rregullorja për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së Komunave.

**2.2 Kuadri institucional për
monitorimin dhe mbikëqyrjen
e Komunave****2.2.1 MONITORIMI I
KOMUNAVE**

MAPL ka instaluar sistemin e monitorimit horizontal dhe vertikal të komunave. Në këtë drejtim, Divizioni i monitorimit në MAPL rregullisht monitoron Komunitat, ndërsa me qëllim të koordinimit të vlerësimit sektorial të akteve ligjore të komunave, MAPL përfaqësohet në 17 grupet ndërmministrorë të themeluara për këtë qëllim. Gjatë vitit 2011, me qëllim të zbatimit të Përgjegjësiave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me Monitorimin dhe Mbikëqyrjen e Komunave, MAPL, ka marrë pjesë rregullisht në monitorimin e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale.

Gjatë periudhës së raportimit, janë monitoruar gjithsejtë 210 mbledhje të kuvendeve të komunave nga 354 sa janë mbajtur në total. Ndërsa me qëllim të matjes së efikasitetit të organeve të administratës së Komunave në vazhdimësi është përcjellë azhureteti i organeve të administratës komunale.

Monitorimi është fokusuar në respektimin e ligjit mbi procedurën administrative, konkretisht, në lidhje me vendosjen e



Raporti pëmbledhës i lendeve

Komuna:

Nr.	Departamenti	Pranuar	Ne proces	Shqyrtuar	Refuzuar	Ne pritje per pranim
1.	Drejtoria për Administratë dhe Personel	30	0	0	0	0
2.	Drejtoria për Arsimit dhe Shkencë	101	1	326	0	0
3.	Drejtoria për Buqësi dhe Zhvillim Rural	222	73	113	0	0
4.	Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet	0	0	0	0	0
5.	Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport	13	67	10	0	0
6.	Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim	11	16	1	0	0
7.	Drejtoria për Punë të Inspeksionit	23	3	10	0	0
8.	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	4	0	0	0	0
9.	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	11	0	1	0	0
10.	Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadas	7	4	0	0	0
Totali:		422	164	470	0	0
Totali shumës se lendeve:					1056	

Nr. faqes:

1

Data e printimit

11

Fig.1. Forma e monitorimit online të efikasitetit dhe azhuritit të administratës së komunave

lëndëve në procedurë administrative në shkallë të parë, vendosjen e lëndëve në procedurë administrative sipas detyrës zyrtare dhe vendosjen e lëndëve në procedurën administrative sipas ankesës.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve ligjore komunale, MAPL ka realizuar tre vlerësime të ligjshmërisë së Statuteve komunale, 18 vlerësime të ligjshmërisë së Rregulloreve lokale, si dhe 284 vendime të karakterit të përgjithshëm, ndërkohë që 57 Rregullore lokale janë dërguar Ministrive përkatëse për vlerësim të ligjshmërisë, për faktin e ndërlidhjes së këtyre rregulloreve me çështjet sektoriale që mbulohen nga këto ministri.

2.1.3 Monitorimi “on-line” i komunave

Gjatë vitit 2011 është funksionalizuar sistemi “on-line” instaluar nga MAPL, nëpër të gjitha Komunitetet (me përjashtim të tre Komunave të veriut: Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan).

Me këtë shumë shërbime komunale për qytetarët mund të ofrohen “on-line” por në të njëjtën kohë, MAPL ka qasje në monitorimin e efikasitetit të punës së komunave për shërbimet ndaj qytetarëve. Gjatë këtij viti është funksionalizuar edhe protokoli elektronik i pranimit të lëndëve. Gjithashtu, me qëllim të avancimit të sistemit të monitorimit dhe me qëllim të uljes së kostos financiare me rastin e monitorimit të komunave, është

realizuar projekti i vendosjes së teleprezencave nëpër Komuna dhe me këtë rast, duke filluar nga viti i ardhshëm, monitorimi i seancave të Kuvendeve të Komunave do të bëhet “on-line”.


12

2.1.4 Raportet periodike për komunat

Gjatë vitit 2011 ka hartuar raportet tremujore të funksionimit të Kuvendeve të Komunave, raportet gjashtëmujore të funksionimit të administratës së Komunave dhe është në proces të draftimit të raportit gjithëpërfshirës vjetor të monitorimit të Komunave.

Këto raporte pasqyrojnë në mënyrë të hollësishme aktivitetet e komunave që dalin si obligim i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Raporti mund të konceptohet si një përmbledhje në lidhje me veprimtarinë e komunave dhe trajton disa nga çështjet kryesore që lidhen me funksionimin dhe qeverisjen e mirë në nivelin komunal.

Raportet përmbajnë të dhëna statistikore, të dhëna krahasimore ndërmjet viteve, konstatime të gjendjes aktuale, konkluzione në lidhje me respektimin e legjisllacionit në fuqi dhe rekomandime përkatëse për funksionim më të mirë të organeve komunale, në mënyrë që qytetarëve, mediave, dhe institucioneve tjera relevante t’u shërbejë si një tregues në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore të komunave.



2.1.5 Monitori i rregulloreve dhe vendimeve të Komunave

Në bazë tremujore është publikuar “Monitori i Rregulloreve dhe vendimeve të Komunave” që pasqyron rregulloret dhe vendimet që merr Kuvendi i Komunës për secilën Komunë. Ky monitor së pari është në shërbim të qytetarëve, mediave dhe të institucioneve, që t’i kenë në dispozicion këto akte të kuvendeve komunale me qëllim të nxitjes së mëtejshme të Komunave për plotësimin e detyrimit që kanë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe së dyti, rritjen e transparencës ndaj publikut të gjerë dhe organeve të interesuara në lidhje me aktet e miratuara në Komunitat e Republikës së Kosovës.

2.2 PERFORMANCA KOMUNALE

2.2.1 Rishikimi i indikatorëve të performancës

Gjatë vitit 2011 në bashkëpunim me Komunitat janë rishikuar indikatorët e performancës së komunave. Janë realizuar dy punëtori dhe një seri e takimeve të përbashkëta me zyrtarët e certifikuar komunal. Të gjitha këto aktivitete janë mbështetur nga projekti USAID/DEMI. Me këtë rast është reduktuar numri i indikatorëve matës të performancës komunale nga 250 në 126.

Këta indikatorë vlejné për pesëmbëdhjetë fusha të kompetencave vetanake të Komunave. Gjithashtu, në bashkëpunim me USAID DEMI dhe SDK/UNDP është finalizuar pyetësori për hulumtimin e opinionit të qytetarëve dhe janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për të filluar punën për draftin e raportit të performancës së shërbimeve komunale për vitin 2011. Për 126 indikatorët, nga 15 fushat e kompetencave komunale është krijuar baza e të dhënave të komunave. Për plotësimin e bazës së të dhënave po punohet në drejtim të transformimit të sistemit ekzistues në softëare-in që MAPL e ka instaluar në të gjitha komunitet. Gjithashtu të gjithë zyrtarët e certifikuar të komunave (gjithsej 397) janë informuar në lidhje me sistemin e ri të performancës.



13

2.2.2 Raporti i performancës komunale

DVL ka ndërmarrë aktivitetet në drejtim të avancimit të sistemit për vlerësimin e performancës komunale, të cilin sistem e ka instaluar që në vitin 2009. Në fillim të vitit, duke përmblusur detyrimin ligjor për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve komunale, DVL ka hartuar raportin e performancës për vitin 2010. Pjesë e këtij raporti janë edhe anketimet e qytetarëve, në lidhje me vlerësimin e performancës së ofrimit të shërbimeve nga komunitet. Ndërsa, nga buxheti i MAPL-së është siguruar një vlerë financiare, që në bashkëpunim me USAID/DEMI i është ndarë komunave që sipas raportit të performancës kanë ofruar shërbimet në mënyrë më cilësore, në raport me qytetarët.

2.2.3 Ndarja e fondeve stimuluese për Komunat -

Në bashkëpunim me USAID/DEMI në komisione të përbashkëta janë përzgjedhur Komunat me performancë më të mirë, të cilat kanë përfituar nga fonde të vogla stimuluese, financim të disa projekteve komunale. MAPL nga buxheti i saj ka ndarë fondet për komunat me performancë më të mirë në lidhje me transparencën komunale ku përfituan 5 Komuna; nivelin e mbledhjes së të hyrave vetanake ku përfituan 5 Komuna dhe menaxhimin e performancës komunale ku përfituan 8 komuna.

2.3 Baza e të dhënave për komunat

Gjatë vitit 2011 është funksionalizuar databazën me të dhëna për komunat. Databaza përfshinë dy lloj informacionesh:

- *Bazën me të dhëna për të gjithë strukturën politike të Komunave, duke përfshirë të dhënat për anëtarët e kuvendeve të komunave dhe të dhënat për ekzekutivin e komunës.*
- *Bazën me të dhëna për të gjitha aktet e miratuara në Kuvendet e Komunave, numrin e seancave, datën kur janë mbajtur evidencën e aktiviteteve të Komunave etj. e cila plotësohet në vazhdimësi.*

3

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOMUNA

3.1 Kuadri ligjor për të drejtat e njeriut

Me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut në nivelin lokal të qeverisjes, MAPL, sipas udhëzimit administrativ për krijimin e njësiteve të të drejtave të njeriut i cili është ndryshuar dhe plotësuar në fillim të vitit 2011, ka punuar me Komunat dhe në vazhdimësi ka mbështetur të gjitha njësitet e të drejtave të njeriut. Me qëllim të funksionalizimit të tyre ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre dhe në vazhdimësi ka monitoruar dhe mbështetur punën e tyre. MAPL, në vazhdimësi ka monitoruar respektimin e gjuhëve zyrtare të Komunave, barazinë gjinore dhe çështje tjera që parashihen me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Lidhur me aktivitetet e komunave në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në nivelin lokal, janë hartuar raportet përkatëse periodike.

3.2 Kuadri institucional

3.2.1 Krijimi i njësiteve të të drejtave të njeriut në komunat e reja

Gjatë periudhës së raportimit janë ndërmarrë të gjitha veprimet për të



15

krijuar dhe funksionalizuar Njësitet e të drejtave të njeriut në Komunitet e reja. Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar vizitat në komunitet e reja me qëllim të informimit të tyre për obligimet që dalin nga udhëzimi administrativ dhe veprimet që duhen ndërmarrë në drejtim të krijimit të NJDNJK-ve. Gjatë kësaj periudhe, janë krijuar NJDNJK-të në komunitet e Gracanics, Klokotit, Parteshit dhe Ranillugut, me ç'rast numri total i NJDNJK-ve arrin në 33. Ndërkaq, me qëllim të certifikimit të këtyre zyrtarëve të njësiteve të reja dhe zyrtarëve tjerë që kanë filluar punën rishtazi në njësitet ekzistuese, është përgatitur plani për zhvillimin e kapaciteteve profesionale. Gjatë këtij viti në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe IKAP-in, ka bërë përgatitjen, dhe zhvillimin e dhjetë moduleve të trajni-

meve për NJDNJK të e reja. Trajnimi kishte për qëllim ndërtimin e kapaciteteve në qeverisje lokale, të zyrtarëve të NJDNJK-ve që janë formuar së fundmi, por edhe të zyrtarëve tjerë të komunitet tjerë, që rishtazi i kanë marrë këto pozita. Gjatë kësaj periudhe kanë përfunduar dhjetë (10) module të trajnimeve dedikuar zyrtarëve të NJDNJK-ve të komunitet të reja dhe zyrtarët e rinj të NJDNJK-ve ekzistuese. Me këtë rast janë certifikuar gjithsej 51 zyrtarë komunal.

3.2.2 Raportet e promovimit të të drejtave të njeriut në komunitet

Është hartuar dhe publikuar raporti i promovimit të të drejtave të njeriut në nivelin lokal, për vitin 2010, i cili

16

përmban aktivitetet e komunave me qëllim të sigurimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Me qëllim që të pasqyrohen aktivitetet e njësiteve të të drejtave të njeriut por edhe të institucioneve tjera përgjegjëse që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut në komuna, janë hartuar raportet periodike dhe raportet tjera. Më poshtë janë listuar raportet e hartuara, për respektimin e të drejtave të njeriut në komuna:

- *Raporti për të drejtat e fëmijëve;*
- *Raporti për barazinë gjinore;*
- *Raportet gjashtëmujore gjithëpërfshirëse për funksionimin e njësiteve të të drejtave të njeriut dhe aktivitetet e komunave për respektimin e të drejtave të njeriut;*

4

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË KOMUNAVE

4.1 Kuadri ligjor dhe dokumentat strategjike

MAPL sipas mandatit të saj ligjor që të sigurojë një shërbim civil profesional në Komuna ka ndërmarrë veprime që edhe gjatë vitit 2011, të plotësojë kornizën e dokumenteve për ngritje të kapaciteteve profesionale në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sipas një sistemi unik për të gjitha Komunitetet e republikës së Kosovës. Me këtë rast, gjatë vitit 2011, është hartuar Dokumenti strategjik për zhvillimin e kapaciteteve të Komunave. Me qëllim të sqarimeve profesionale të koncepteve themelore dhe rëndësinë e ndërtimit të kompetencës profesionale në komuna, është hartuar dokumenti konceptual, i shoqëruar edhe me dokumente tjera përcjellëse profesionale: sistemin e ngritjes së kapaciteteve, kornizën logjike, planprogramet për fushat dhe nivelet përkatëse dhe planet trajnuese. Së bashku me Planin Strategjik u botua edhe fletëpalosja me titull “Ndërtimi i Karrierës tuaj”,

4.2 Qasja gjithëpërfshirëse për zhvillimin e kapaciteteve të Komunave

Vlerësimi i kapaciteteve të Komunave-Qëllimi i këtij vlerësimi ishte që për herë të dytë të vlerësohen kapacitetet e komunave dhe të identifikohen aseteve dhe dobësitë në kapacitete në nivelin komunal, në kontekstin e procesit të decentralizimit, i shoqëruar me transferimin e kompetencave drejt komunave. Vlerësimi i kapaciteteve të komunave është bërë me qëllim të krahasimit të kapaciteteve në raport me vitin 2009, ndërkajë gjetjet e vlerësimit të kapaciteteve do të përbëjnë bazën e rekomandimeve për ndihmën dhe zhvillimin e kapaciteteve komunale që pastaj MAPL mund t'ua prezantojë edhe donatorëve edhe vetë strukturave komunale në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve profesionale në nivelin lokal, si pjesë esenciale e efikasitetit të punës së administratës. Gjatë vitit 2011, ka përfunduar procesi i zhvillimit të pyetësorëve dhe në gjithsej 33 Komuna është bërë vlerësimi i kapaciteteve sipas pyetësorëve me gjithsej 495 zyrtarë komunal. Është bërë krijimi i bazës elektronike të të dhënave për futjen dhe përpunimin e të dhënave në mënyrë elektronike. Pas analizimit të të dhënave ka filluar të përgatitet drafti i parë i raportit për vlerësimin e kapaciteteve të Komunave. Raporti përbëhet prej tre

kapitujve: Kapitulli i, pasqyron qëllimin, mjetet dhe metodologjinë e punës; kapitulli II, pasqyron të dhënat krahasuese për vitin 2009 dhe 2011, pasqyrën krahasuese e të dhënave sipas fushave përkatëse duke përfshirë edhe vlerësimet përkatëse të kapaciteteve për secilën fushë; kapitulli III, pasqyron përfundimet e nxjerra nga krahasimi i të dhënave dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe shtojca në fund, përmban pyetësorin dhe udhëzimin për administrimin e pyetësorit.

Ndërkaq me qëllim të sqarimeve profesionale të koncepteve themelore dhe rëndësinë e ndërtimit të kompetencës profesionale në komuna (KPK), është hartuar dokumenti “korniza e kompetencës profesionale”, i shoqëruar edhe me dokumente tjera përcjellëse profesionale që avancojnë sistemin e ngritjes së kapaciteteve profesionale të komunave. Gjithashtu është rifreskuar me të dhëna shtesë lista e institucioneve ndërkombëtare që merren me ngritjen e kapaciteteve sipas fushave përkatës dhe është rifreskuar lista e donatorëve të mundshëm dhe organizatave ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve në komuna;

4.3 Programet e trajnimeve dhe organizimi i tyre

Me rastin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të menaxhimit të pronës publike komunale dhe Ligjit për partneritetin

Publiko-privat, janë organizuar trajnimet me zyrtarët komunal. Ndërsa me qëllim të informimit sa më të mirë, të zyrtareve komunal të komunave të reja, duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e Kuvendeve të Komunave dhe Komiteteve, në bashkëpunim me USAID/DEMI, janë organizuar trajnime, me temat si vijon: transparenca Komuna; mbikëqyrja e akteve komunale dhe menaxhimi i pronës komunale.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale, të stafit të MAPL-së, në bashkëpunim me ECORYS është disajnuar projekti për 5 module trajnimi. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 16 zyrtarë nga të gjitha departamentet e MAPL.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të komunave është hartuar Plani i trajnimit për Komunitet e reja. Plani i trajnimit është bazuar në rekomandimet e auditorit gjeneral. Gjithashtu është hartuar Plani i Trajnimeve për Ekipin Përgatitor për Themelimin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ndërsa, në bashkëpunim me OSBE-në, është hartuar dhe është realizuar projekti për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal, në lidhje me cilësinë e akteve komunale. Me këtë rast, janë organizuar seminare dyditore me të gjithë drejtorët e Administratës së komunave dhe kryesuesit e kuvendeve të Komunave,



zyrtarët ligjorë, zyrtarët përgjegjës të ministrive të linjës për vlerësimin ligjor të akteve të komunave etj.

- Në bashkëpunim dhe përkrahje të OSBE-së janë organizuar dhe mbajtur punëtori dhe trajnime për Fuqizimin e NJDNJK-ve në pesë komuna: Istog, Dragash, Podujevë, Obiliq dhe Ferizaj;
- Është organizuar dhe mbajtur seminari dy ditor me pesë NJDNJK e përzgjedhura: Obiliqi, Podujeva, Ferizaj, Dragashi dhe Istogu;
- Gjithashtu në mbështetje të OSBE-së janë mbajtur trajnime regjionale për Personat me Aftësi të Kufizuara në: Pejë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë dhe Prishtinë si dhe
- Trajnimi 5 ditor për barazi gjinore në komunën e Vitisë.

5

INTEGRIMET
EVROPIANE**5.1 Dokumentet strategjike
për agjendën evropiane**

Bazuar në orientimet strategjike për aderim në strukturat evropiane edhe MAPL sipas agjendës qeveritare, gjatë vitit 2011, ka koordinuar aktivitetet me komunat në drejtim të përmbushjes së obligimeve për agjendën evropiane. Gjatë vitit 2011, MAPL ka raportuar rregullisht lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në bazë tremujore dhe rregullisht ka dhënë kontributin e saj në rishikimin dhe finalizimin e PVPE për vitin 2011.

**5.2 Ngritja e kapaciteteve
institucionale të komunave
për agjendën evropiane**

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin në procesin e liberalizimit të vizave dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar, gjatë vitit 2011 MAPL, në bashkëpunim të ngushtë me MPB-në ka ndërmarrë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve komunal. Me këtë rast, janë trajnuar rreth 250 zyrtarë komunal. Ndërsa, me qëllim të sigurimit të mbështetjes në këtë proces dhe për të vlerësuar përmbushjen e obligimeve që dalin nga Strategjia për Re-integrimit e personave të riatdhesuar janë organizuar vizita në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

6

PROGRAMET E
BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR ME
VENDET FQINJE

19

**6.1 Kuadri ligjor dhe dokumentat
bazike për bashkëpunimin
ndërkufitar**

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK) është instrument i financuar nga BE dhe i bashkë-financuar nga shtetet bashkëpunuese që ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit në mes të popullatës dhe institucioneve në regjionet kufitare, për të përmirësuar zhvillimin ekonomik, ruajtjen e ambientit dhe kohezionin e qëndrueshëm social.



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për zbatimin e Programeve IPA të BNK ndërmjet Kosovës me shtetet fqinjë. Kosova momentalisht është e përfshirë në bashkëpunim ndërkufitar me fqinjët e saj maqedonas, shqiptar dhe malazezë. Në korrik, 2011 është nënshkruar marrëveshja financiare në mes të Komisionit Evropian dhe dy shteteve Kosovës dhe Maqedonisë, duke shënuar kështu fillimin e implementimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve. Në shtator të vitit 2011, është nënshkruar marrëveshja financiare për programin e bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës dhe Shqipërisë. finalizimit të dokumentit të programit për programin BNK.

6.2 Korniza institucionale

6.2.1 Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë - Gjatë vitit 2011 në serinë e takimeve të rregullta janë organizuar edhe tre takime të strukturave operative, me qëllim të implementimit të programit për bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Është themeluar Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, i cili realizoi takimin e parë në nëntor 2011, ndërsa ZNKE dhe MAPL kanë nënshkruar marrëveshjet për grantet për asistencë teknike për implementimin e BNK-së. Pas nënshkrimit të marrëveshjes është

rekrutuar Sekretariati i përbashkët teknik (JTS), të cilët do të punojnë në JTS antenna në Prizren dhe në zyrën e JTS në Kukës.

Ndërkaq, janë bërë përgatitjet për thirrjet për propozime për BNK Kosovë-Shqipëri.

Me këtë rast KE ka aprovuar grantin në vlerë prej 600.000.00 EURO. Fillimi i vitit 2012 do të jetë koha kur to të lansohet ky aktivitet dhe të fillojë implementimi i këtij programi. Ndërsa, MAPL dhe strukturat përgjegjëse të Malit të Zi kanë finalizuar bashkërisht draft dokumentin e programimit për bashkëpunim ndërkufitar i cili është proceduar më miratim tek Komisioni Evropian.

6.2.2 Programi i bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë - Në përgatitje të fillimit të implementimit të programit BNK Kosovë-Maqedoni janë mbajtur takime bilaterale të strukturave operative dhe delegacioneve të BE-së dhe përfaqësuesve të të dy shteteve. Projekti i parë në kuadër të këtij programi do të jetë projekt strategjik në lidhje me ndërtimin e vendkalimit të përbashkët kufitar Belanovc-Stancic. Gjatë vitit 2011 janë themeluar Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (KPM si strukturë e përbashkët operative, ndërsa MAPL ka koordinuar të gjitha aktivitetet edhe me institucionet tjera relevante për të ndërmarrë parapërgatitjet për studimin e fizibilitetit që do t'i paraprijë ndërtimit të vendkalimit të përbashkët kufitar.

7

ZHVILLIMI REGJIONAL

7.1 Kuadri ligjor dhe institucional

MAPL edhe gjatë vitit 2011 ka punuar ngushtë me pesë Agjencionet për Zhvillim Regjional të cilat janë themeluar në vitin 2009. Janë finalizuar 5 Strategji për Zhvillim Regjional dhe Planet e Veprimit për implementim të këtyre strategjive dhe kanë ndërmarrë aktivitete të përbashkëta me Komunat, në drejtim të implementimit të tyre. Gjithashtu, gjatë vitit 2011 është dhënë granti në vlerë prej 4 Milion Euro, ku kanë përfutur pesë Regjionet Ekonomike, përfshirë institucionet lokale, OJQ-të, asociacionet e ndryshme joqeveritare. Ndërsa, gjatë këtij viti, në bashkë-

punim me zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian janë hartuar konceptet themelore për zhvillimin regjional të cilat e kanë bazën në dy dokumente konceptuale: analizë krahasuese të politikave të zhvillimit rajonal dhe të strukturave të ngjashme nga rajoni apo vendet e tjera në Evropë, dhe një vështrim i përgjithshëm i koncepteve të Bashkimit Evropian dhe praktikave të zhvillimit rajonal.

7.2 Zhvillimi i projekteve të investimeve publike

Duke punuar me komunat MAPL ka financuar 76 projekte nga buxheti i vet, dhe rreth 2 herë më shumë në bashkëpunim me komunitetin e donatorëve. Shuma e financuar nga MAPL është 6.35 milionë EURO.

Ndërkaq nga fondi IPA për vitin 2011, programi për infrastrukturë Komunale Ekonomike dhe Sociale kane filluar të realizohen 6 Projekte, vlera e kontratës 7,612,294.68 EURO.

Tabela 1. Sektorët e investuar, numri projekteve dhe vlera e tyre

Sektori	Numri i Projekteve	Vlera në EURO (€)
Rrjeti i rrugëve lokale	26	2,449,424.41 €
Rrjeti i sistemeve të kanalizimit	4	374,558.29 €
Rrjeti i sistemit të furnizimit me ujë	2	230,870.00 €
Ndërtimi dhe rregullimi i objekteve administrative	5	1,409,651.00 €
Sistemi arsimor	5	596,500.00 €
Sistemi shëndetësor	1	229,282.00 €
Kulturë, rini dhe sport	6	105,604.72 €
Ambient	3	302,000.00 €
Shërbime publike	10	533,629.16 €
Zyrat e Vendit	4	110,284.00 €
Tjera	3	10,398.55 €

8

KORNIZA E DOKUMENTAVE
STRATEGJIKE DHE
ANALIZAT LIGJORE TË
ZHVILLUARA NGA MAPL

22

Me qëllim të përmbushjes së objektivave për vitin 2011, MAPL punën e saj e ka drejtuar për të hartuar orientimet strategjike që ndikojnë në avancimin e demokracisë lokale. Me këtë rast, është hartuar drafti i Strategjisë për vetëqeverisjen Lokale, 2012-2015. Strategjia për vetëqeverisjen lokale 2012-2015 do të jetë një dokument themelor që tregon drejtimin dhe orientimet e vetëqeverisjes lokale për vitet në vijim. Strategjia synon të koordinojë dhe të sistematizojë tërësinë e aktiviteteve që ndërmerren në fushën e pushtetit lokal dhe ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarit përmes rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pushtetit lokal, si dhe rritjes së efikasitetit të administratës lokale.

Gjatë vitit 2011, me qëllim të avancimit të sistemit gjithëpërfshirës dhe unik të zhvillimit të kapaciteteve të komunave është hartuar strategjia për zhvillimin e kapaciteteve profesionale. Ky dokument strategjik ka për qëllim që të bëjë parashikimin dhe sistemin e veprimeve institucionale të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të komunave dhe akterëve tjerë relevant që do të marrin pjesë në ngritjen dhe zhvillimin e kapacit-

eteve profesionale të komunave. Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar edhe dokumentat si vijon:

- *Udhëzuesi për Ngritjen e cilësisë së akteve të komunave;*
- *Doracakut i ligjeve që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale si dhe mekanizmit për identifikimin e obligimeve ligjore që dalin për komunat, nga ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për vitin 2011;*
- *Dokumenti i indeksit të akteve nënligjore të miratuar nga MAPL-ja dhe dërgimi i tyre në Zyrën Ligjore të Kryeministrit për periudhën 2004-2011;*
- *Analiza për organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve publike;*
- *Analiza ligjore për kompetencën e deleguar/shënimet kadastrale;*
- *Analiza ligjore, lidhur me funksionimin e Agjencive Zhvillimore Rajonale;*
- *Analiza ligjore, lidhur me punonjësit në veri të Mitrovicës.*

9 KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

23

Për të promovuar procesin dhe për të njoftuar të gjithë palët me interes lidhur me iniciativat e BNK-së, MAPL ka ndërmarrë aktivitetet si vijon: ka organizuar një aktivitet kinematografik ku kanë marrë pjesë më tepër se 200 përfaqësues të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile, donatorëve, studentëve dhe nxënësve nga mbarë Kosova. Gjithashtu janë publikuar dy buletine informative dhe është ri-dizajnuar uebfaqja www.cbckosovo.eu në tri gjuhët, e cila azhurnohet rregullisht dhe shërben si platformë informimi dhe komunikimi me të gjitha palët me interes. Gjatë vitit 2011 është prodhuar një video prej 6 minutash, si përmbledhje e iniciativave të BNK-së në mes të Kosovës me shtetet fqinje, janë prodhuar tre dokumentarë televiziv mbi bashkëpunimin ndërkufitar që do të transmetohet në televizionin publik të Kosovës (RTK) në fillim të vitit 2012, si dhe janë organizuar një sërë aktivitetesh (ligjërata, takime, intervista në radio) etj. Vëmendje e veçantë në raport të komunikimit me media i është kushtuar informatave të dërguara në media pas çdo aktiviteti, si dhe realizimit të të gjitha kërkesave të gazetarëve për të siguruar dokumente dhe për të marrë informata

lidhur me këtë proces. Janë dërguar në media 52 komunikata, 41 njoftime dhe janë organizuar 13 Konferenca për media. Pjesë e rëndësishme e zbatimit të transparencës së MAPL-së në raport me të informimin e qytetarëve është edhe postimi i informatave dhe dokumenteve të rëndësishme në të Ministrisë në ueb aplikacionin www.mapl-ks.org; ku në vitin 2011 janë publikuar gjithsej 93 informata. Komunikimi me qytetarë është bërë edhe përmes TV spoteve dhe billbordeve që janë transmetuar në 15 ditë gjatë vitit në të gjitha stacionet televizive dhe radio të nivelit nacional. Janë realizuar 3 takime jo-formale me redaktorë të medieve për të kuptuar mënyrat më të mira që ministria të jetë në funksion të transparencës dhe komunikimit. Komunikimi me qytetarët në veri të Kosovës ka qenë në prioritet të ministrisë dhe në për këtë kemi përgatitur: planin për fushatën informuese dhe komunikimin me qytetarët që ka pasur 4 objektiva: përgatitjen e materialeve propaganduese për media, planin për komunikim medial, planin për komunikim me qytetarë dhe planin për komunikim me grupe të interesit dhe organizata jo-qeveritare.



Republika e Kosovës
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

[Ballina](#)
[Ministria](#)
[Ligjet dhe aktet nënligjore](#)
[Publikime](#)
[Komunat e Kosoves](#)
[Fotogaleria](#)
[Lajme dhe ngjarje](#)

Mirësevini!

Avancimi i Qeverisjes Lokale në bashkëpunim me Institucionet tjera relevante, që konsiston në sigurimin e shërbimeve efikase në nivel komunal dhe sa më afër qytetarëve.

Për Kosovën

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Himni i Republikës së Kosovës
- Ligji për qasje në dokumente publike
- Portali qeveritar

Për Komunat

- Bashkëpunimi Ndërkomunal
- Portali i Komunave
- Indikatorët e performancave
- Investimet e donatoreve

DECENTRALIZIMI NË KOSOVË

- Një hap drejt Integrimit në Bashkësinë Evropiane



Lajme dhe ngjarje



14 dhjetor 2011
Zëvendësi i Thaçit lavdërohet me privilegjet që ka UNE JAM KOSOVAR
Jam Serb dhe nuk kam problem ta them këtë, por kam pasaportën diplomatike të Qeverisë së Kosovës dhe Shtetësinë e Kosovës.



14 dhjetor 2011
Takimi i Grupit Ndër - Ministror për Decentralizim
Zëvendëskryeministri Petrović: "Suksesi i padiskutueshëm është

Konferenca e Dytë Ndërkombëtare për Vetëqeverisje Lokale 05-06 shtator 2011



Buxheti për vitin 2011, Mjetet e akorduara dhe shfrytëzimi i tyre

	Shpenzimet			Zotimet		Progresi i zotimeve, me buxh e akorduar 2010 në %	Progresi i shp. me buxh. 2011 në %	Mjetet e pasf. nga mjetet e akorduara	Mjetet ne disponim	
	Buxheti i akorduar	Buxheti i paakorduar	Zotimet	Shpenzimet e paguara	Të pashlyera: Zotimet/Obligimet					F
Buxheti 2011	A	B	C=A-B	D=E+F	E	F				
Kategoria										
Rrogat dhe pagat (103)	521,537.00	521,537.00	-	-	445,505.90	-	0.00	85.42	76,031.10	76,031.10
Mallra dhe Shërbime	263,058.00	247,695.00	15,363.00	247,490.27	234,338.79	13,151.48	99.92	89.08	204.73	15,567.73
Shpenzimet Komunale	30,000.00	28,708.65	1,291.35	28,708.65	28,708.65	-	100.00	95.70	-	1,291.35
Subvencione dhe transfere	430,249.00	429,319.33	929.67	439,012.10	423,053.00	15,959.10	102.26	98.33	(9,692.77)	(8,763.10)
Pasuritë Jofinanciare	5,968,933.00	5,916,018.31	52,914.69	5,916,010.41	5,775,430.16	140,580.25	100.00	96.76	7.90	52,922.59
113-Shërbimet Adm. Qendrore	7,213,777.00	7,143,278.29	70,498.71	6,631,221.43	6,907,036.50	169,690.83	92.83	95.75	66,550.96	137,049.67
Pagat&Shesat (9)	109,913.00	109,913.00	-	0.00	97,244.62	-	-	88.47	12,668.38	12,668.38
Mallrat&Shërbimet	50,000.00	46,486.58	3,513.42	46,486.58	41,873.61	4,612.97	100.00	83.75	-	3,513.42
114-Zyra e Ministrimit	159,913.00	156,399.58	3,513.42	46,486.58	139,118.23	4,612.97	29.72	87.00	12,668.38	16,181.80
Pagat & Meditje (20)	145,530.00	145,530.00	-	-	118,282.50	-	-	81.28	27,247.50	27,247.50
Mallra dhe Shërbime	140,786.10	138,615.61	2,170.49	138,615.61	127,812.67	10,802.94	100.00	90.79	-	2,170.49
Shpenzimet Komunale	9,000.00	9,000.00	-	8,952.38	8,952.38	-	99.47	99.47	47.62	47.62
Pasuritë Jofinanciare	400,891.12	400,891.12	-	400,891.12	352,605.29	48,285.83	100.00	87.96	-	-
Rezervat	29,161.78	-	29,161.78	-	-	-	-	-	-	29,161.78
245-Fondi Konfigjent-kom.e reja	725,369.00	694,036.73	31,332.27	548,459.11	607,652.84	59,088.77	79.02	83.77	27,295.12	58,627.39
Pagat&Shesat(139)	776,980.00	776,980.00	-	661,033.02	661,033.02	-	85.08	85.08	115,946.98	115,946.98
Mallrat&Shërbimet	453,844.10	432,797.19	21,046.91	432,592.46	404,025.07	28,567.39	99.95	89.02	204.73	21,251.64
Shpenzimet Komunale	39,000.00	37,708.65	1,291.35	37,661.03	37,661.03	-	99.87	96.57	47.62	1,338.97
Subvencione dhe Transfere	430,249.00	429,319.33	929.67	439,012.10	423,053.00	15,959.10	102.26	98.33	(9,692.77)	(8,763.10)
Shpenzimet Kapitale	6,369,824.12	6,316,909.43	52,914.69	6,316,901.53	6,128,035.45	188,866.08	100.00	96.20	7.90	52,922.59
Rezerva	29,161.78	-	29,161.78	-	-	-	-	-	-	29,161.78
MAPL	8,099,059.00	7,993,714.60	105,344.40	7,887,200.14	7,653,807.57	233,392.57	98.67	94.50	106,514.46	211,858.86
Donacion / Banka Boterore (auditim	1,400.00	1,400.00	-	1,400.00	1,400.00	-	100.00	100.00	-	-
MAPL	8,100,459.00	7,995,114.60	105,344.40	7,888,600.14	7,655,207.57	233,392.57	98.67	94.50	106,514.46	211,858.86